

ÇFARË PËRFAQËSON?

SELIA DHE KONTAKTET

1

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm është gjykata e vetme në nivel apeli, e cila vijon rregullisht ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore e administrative të të gjitha gjykatave të apelit.

2

Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm fillon funksionimin më datë 01.02.2023.

3

Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, ndërpresin veprimtarinë në datë 31.01.2023.



Adresa e Gjykatës:

Bulevardi "Zhan D'Ark"
(Godina aktuale e Gjykatës së Apelit Tiranë)

Kontakte:

✉ sherbime@gjykata.gov.al

☎ +355 67 73 74 414

📞 +355 67 73 74 414



GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

CILAT JANË ORGANET E
ADMINISTRIMIT GJYQËSOR?

- **Këshilli i Gjykatës**
- **Kryetar/Zëvendëskryetar**
- **Kancelar**

TRANSFERIMI DHE MENAXHIMI I ÇËSHTJEVE GJYQËSORE NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË TRANSFEROHEN NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

ÇËSHTJET GJYQËSORE QË NUK RINDAHEN ME SHORT

Çështjet gjyqësore të transferuara, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtrohen rindarjes me short.

Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë.

Planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor, në Gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, do të bëhet deri në 31.12.2022. Ky rregull nuk gjen zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit.